



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 65**

Datë: 07. 10. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

**3. Aktivitetet e ZRPPC-së:**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve.

**4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

**Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPPC-së, në lidhje me pjesën e 10% të Fondit për përkrahje të subjekteve politike.

## **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ri shqyrtim të specifikave për format zgjedhore për zgjedhjet e lokale 2021.

### **5. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik.**

### **6. Të ndryshme.**

---

#### **1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kreshnik Radoniqi:** E kemi rendin e ditës para vetes. A ka dikush diçka të shtojë në rend të ditës ? Urdhëro z. Dushi...?

**Florian Dushi:** Faleminderit kryesues. Unë po besoj që te pjesa e aktiviteteve të sekretariatit ose në të ndryshme, do të duhet të njoftohemi me procedurat problematike për të cilat diskutuam javën e kaluar dhe, me e pa se deri ku ka arritur Sekretariati në zhvillimin e tyre.

**Kreshnik Radoniqi:** Dikush tjetër ? Nuk ka. Atëherë, a mundemi të votojmë ? Kush është për këtë rend dite ?

Me vota unanime miratohet rendi i ditës. Vazhdojmë me aktivitetet e tjera...

#### **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ -së**

**Burim Ahmetaj:** Sekretariati, është në vazhden e përgatitjeve për organizimin e zgjedhjeve që do të mbahen me 17 tetor. Në kuadër të aktiviteteve, i kemi përfshirë në pika të shkurtër të gjitha aktivitetet të cilat janë në përgatitje e sipër, si dhe aktivitete të Sekretariatit. Më lejoni të ju njoftoj se për periudhën e votimit jashtë Kosovës, periudhë e cila ka filluar me 15 shtator dhe do të përfundojë më 15 tetor; Pra deri me datën 5 tetor, KQZ ka pranuar gjithsej 2337 pako të supozuara me fletëvotime. Paket me fletëvotime, janë tërhequr nën përcjelljen e policisë nga zyrat postare nga qendra tranzitore e Kosovës posta nr.6, si dhe postat e shpejta DHL. KQZ, do t'a bëjë pranimin e fletëvotimeve, pra paket me fletëvotime të supozuara deri me datën 15 tetor. Periudha tjetër, është periudha e regjistrimit të personave me nevoja të veçanta. Sipas të dhënave preliminare, janë regjistruar deri më tani 3200 votues sipas kategorive. Në kategorinë e parë, votues me nevoja të veçanta janë rreth 1800 votues, në kategorinë e dytë votues në institucione janë rreth 1400. Në kategorinë e tretë: votues me rrethana të veçanta, deri më tani janë 28, pra numri përfundimtar i votuesve për këto tri kategori duhet të dihet deri në fund të kësaj jave, ngase Sekretariati është duke i bërë të gjitha verifikimet e të dhënave të pranuar nga

institucionet, qendrat e paraburgimit, qendrat korrektuese. Deri në fund të kësaj jave, do ta kemi të saktë numrin e votuesve të regjistruar për secilën kategori.

Më lejoni të ju njoftoj se shtypja e listave përfundimtare të votuesve, është në proces e sipër, pra ka filluar me datën 4 tetor 2021. Pra janë lista përfundimtare të votuesve dhe listat komunale të votuesve dhe aktualisht, ky proces është në procesin e shtypjes të listave komunale të votuesve; Ndërsa shtypja e listave përfundimtare të votuesve, është kompletuar, pra është realizuar në tërësi procesi i printimit.

Sekretariati, është duke e bërë kontrollimin teknik dhe paketimin e listave të votuesve sipas komunave dhe qendrave të votimit. Aktivitet tjetër, është trajnimi i anëtarëve të këshillave të vendvotimeve i cili, pritet të fillojë më datën 9 tetor. Ky trajnim, do të fillojë përnjëherë në të gjitha komunat dhe për këtë, janë bërë edhe përgatitjet. Jemi në procesin e përkrahjes edhe me doracakë të cilët, janë në proces e sipër dhe për ti shpërndarë nëpër komuna.

Sekretariati pra i ka shpërndarë edhe pakot e trajnimit. Trajnim tjetër i cili pritet të fillojë ditën e nesërme, është trajnimi i stafit të rezultateve preliminare të votuesve i cili do të zgjas deri në ditën e marte, kur do të trajnohen më shumë se 900 pjesëtarë të stafit të cilët do të dërgohen nëpër secilën qendër të votimit në të gjithat komunat. Trajnimi, do të zhvillohet në objektin e QNR-së. Më lejoni të ju njoftoj se, tashmë kanë arritur fletëvotimet për kryetar komune dhe për kuvendin komunal, si dhe broshurat e kandidatëve për kuvendin komunal. Në depon qendrore të KQZ, me datën 6 tetor është bërë pranimi teknik i tyre dhe printimi i fletëvotimeve është bërë në Slloveni. KQZ, gjatë gjithë kohës e ka monitoruar procesin e shtypjes dhe printimit si dhe kontrollimin e kualitetit të fletëvotimeve për kryetar komune dhe kuvendin komunal. Ndërsa, sa i përket fushatës zgjedhore për periudhën 20 ditore: nga data 16 shtator deri me datën 5 tetor, sipas raporteve nga komisionet komunale të zgjedhjeve janë paraqitur 629 kërkesa për tubime politike duke respektuar rregullat zgjedhore të KQZ dhe masat mbrojtëse anticovid. Deri me datën 5 tetor, sipas raportimeve janë mbajtur 15 tubime politike, pa i përfillur rregullat zgjedhore dhe vendimin e qeverisë së Kosovës për masat mbrojtëse antikovid. Nga 629 kërkesa për tubime politike, prej tyre 110 tubime nuk janë mbajtur fare dhe pse janë lajmëruar në komisionin komunal të zgjedhjeve dhe në polici.

Nga vizitat që kemi pasur në terren, përkatësisht në regjionin e Kaçanikut dhe të Hanit të Elezit, jemi njoftuar së bashku me KQZ nga afër me problematikën e votuesve të cilët, kanë dy shtetësi, pra janë me shtetësi të Republikës së Kosovës dhe shtetësi të Republikës së Maqedonisë të Veriut. Madje, e dimë edhe faktin se zgjedhjet do të mbahen në të njëjtën datë: edhe në Kosovë edhe në Maqedoninë e Veriut. E kemi edhe një imell nga zyrtari komunal që e kemi në komunën e Hanit të Elezit që e ngritë si shqetësim se si

të veprojmë me këta votues që kanë dy shtetësi, dhe të njëjtit mund të votojnë edhe në Republikën e Kosovës edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Pra, tha z. Ahmetaj, shpresoj që KQZ do të marrë ndonjë vendim për këtë çështje e cila, na obligon për të zbatuar nenin 17.1, pra ti japë të drejtë secilit votues për të votuar. Ndërsa, sa i përket aktiviteteve të prokurimit më lejoni të ju njoftoj se procedura e printimit apo furnizimit me doracakë është e kompletuar dhe tani jemi në fazën e printimit të doracakëve të votimit dhe numërimit ndërsa në proces janë edhe procedurat me furnizim me ID bexha, sprejin ultraviolet dhe materialet anticovid ndërsa për format zgjedhore pritet pas vendimit të KQZ-së të veprojmë sipas vendimit të KQZ-së. Më lejoni të ju njoftoj se, në këto momente kur po raportojmë është bërë edhe vlerësimi për furnizimin me materiale ultraviolet dhe për ID bexha. Edhe materiale të covidit, është në proces e sipër dhe gjatë ditës së sotme do të bëhet edhe procesi i vlerësimit duke respektuar edhe nevojën emergjente ekstreme në fazën në të cilën ndodhemi...

**Ilir Gashi:** Faleminderit, unë desha edhe njëherë të diskutoj për faktin se ka një lloj paqartësie rreth kërkesës që e pat Ministria e Arsimit lidhur me mbajtjen e aktiviteteve të subjekteve politike dhe mos mbajtjen, më mirë të them në objekte shkollore. Prandaj, ajo dilema e tubimeve nëse ajo rregull do të vlejë për brenda shkollave apo, a është e lejueshme në oborret e shkollave. Besoj që ndoshta keni vu kontakt me ministrinë edhe e keni qartësuar këtë çështje...

**Sami Kurteshi:** Unë, e kam lexuar raportin dhe e kam dëgjuar me kujdes. Ju thatë më 9 shtator mbahen ato trajnimet, po më 9 tetor është fjala.. Ju, edhe e keni të shkruar me 9 tetor. E dyta, është çështja e materialeve, d.m.th KKZ-së materialeve të ndjeshme; Në Kllokot, zyrja e KKZ-së me gjasë (kemi qenë bashkë) është në objekt privat, e aty ruhen edhe materialet e KKZ-së ? Aty, shkojnë edhe këto materialet e ndjeshme ditën para zgjedhjeve, pra në objekt privat. Se di si është i ruajtur...! Çështja tjetër, është: e shihni në faqen e dytë të raportit tuaj të fushatës zgjedhore - paragrafi i dytë - fjala krejt e fundit në paragrafin e dytë ku thotë - fushata zgjedhore vazhdon te jetë akoma e qetë.... ! A jeni duke pritur ndonjë incident, apo...? Sidoqoftë, po gëzohem që situata është e qetë. Dhe, çështja e fundit: mua po më vjen mirë që u hap kjo çështje e Hanit të Elezit. KKZ e ka ngritur këtë çështje të qytetarëve që kanë dy shtetësi dhe të drejtë vote: edhe në Maqedoni, edhe në Kosovë. Dhe më 17 tetor, zgjedhjet komunale janë në të dy vendet...

Ne, nuk kemi ndërmarrë diçka. Unë, e kam ngritur këtë çështje për diskutim por nuk kam ndonjë qëndrim, d.m.th., ti lëmë me votuar ose të mos i lëmë me votuar apo, nuk e di si është...Sidomos, ka me qenë

problemi te çështja e ngjyrave, e gishtërinjve nëse në Maqedoni votojnë përpara edhe ju qesin ngjyrë-sprej në gishta dhe vijnë në Kosovë e votojnë, edhe pse ata në lista ata mund të jenë...Nuk e di nëse Maqedonia ju qet apo nuk ju qetë ngjyrë në gishta...

**Alim Rama:** Unë, po flas për regjistrimin e votuesve me nevoja të veçanta! Por edhe sa i përket shqetësimit për votuesit nga Hani i Elezit. Unë kam pritë që Sekretariati të vijë me një rekomandim në fund të fundit, ose nëse e konfirmon Maqedonia se a përdoret ajo ngjyra e njëjtë dhe, cili është rekomandimi! Sa i përket trajnimit të anëtarëve të këshillave, kemi shumë shqetësime prej anëtarëve të KKZ-ve sepse, ky është vikendi i fundit dhe unë kisha pritë prej Sekretariatit që të bëjë gjithçka që furnizimi me materiale trajnuese të jetë për ditën e shtunë gati, kur edhe fillon trajnimi pavarësisht rrethanave...

**Burim Ahmetaj:** Më lejoni të ju njoftoj se z. Radoniqi vec e ka shkruar një shkresë që ia ka dërguar Ministrisë së Arsimit duke theksuar se KQZ nuk administron me shkolla, dhe është në kompetencë të Ministrisë së Arsimit të administrojë me hapësirat e brendshme dhe të jashtme të shkollave. Mirëpo, ajo që e kemi theksuar në shkresë është se edhe adresimi për KQZ-në... Kjo për neve nuk paraqet ndonjë problem nëse organizojnë në hapësirat e jashtme, mirëpo duhet paraprakisht miratimi i Ministrisë së Arsimit. Pra, në secilën rrethanë Ministria e Arsimit, drejtoritë e arsimit komunale janë ato që menaxhojnë dhe administrojnë me shkollat dhe ato japin leje, ndërsa KQZ kryen këtë pjesën formale të lejimit të një tubimi politik në çfarëdo hapësire publike në bashkëpunim me policinë. Ndërsa, sa i përket pyetjeve tjera që ka të bëjnë me komunën e Kllkotit, ne kemi qenë në vizitë në komunën e Kllkotit dhe aty shfrytëzohen zyrat e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve dhe hapësira e depos shfrytëzohet në një objekt privat. Kështu që praktikisht, i bjen që në objekte private zhvillohen të gjitha veprimtaritë në mungesë të sigurimit të hapësirave publike. Kemi zotimin që do të bëhet një sigurim, por kjo i bie që pas ditës së zgjedhjeve do të jetë një sigurim i hapësirave publike nga komuna...

Ndërsa, për votuesit me dy shtetësi që praktikisht nuk është shqetësim vetëm i komunës së Hanit të Elezit por është edhe i komunës së Kaçanikut, i komunës së Vitisë dhe i komunës së Gjilanit, ka një numër të votuesve që kanë dy shtetësi dhe Sekretariati është duke analizuar lidhur me këtë.....Me rëndësi është që si në Republikën e Kosovës po ashtu në Republikën e Maqedonisë, procedurat të identifikimit pothuajse janë të njëjta Kosova: përdor sprejin ultraviolet për të spërkatë gishtin njëjtë edhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Në rast se njëra ose tjetra, ose votuesi voton më herët në Kosovë ose në Maqedoni, i bie që me këto procedura, aktualisht të mos mund të votojë në votimin e dytë. Mirëpo, jemi duke shqyrtuar këtë problematikë, dhe në mbledhjen e radhës do të vijmë me një propozim konkret.

Sa i përket votuesve me covid, ky proces është në proces e sipër, jemi duke i regjistruar të gjithë votuesit të cilët janë të infektuar me covid. Atyre, do të ju japim mundësi të votojnë përmes ekipeve mobile. Në lidhje me trajnimin e anëtarëve të këshillave të vendvotimeve, i kemi bërë të gjitha përgatitjet që trajnimi i anëtarëve të këshillave të vendvotimeve të fillojë me datën 9 tetor. Për shkak të rrethanave, furnizimin nuk mund ta kemi në tërësi me doracakë për të gjitha komunat mirëpo, në mënyrë progresive do ta bëjmë shpërndarjen e doracakëve për nevoja të trajnimit, ndërsa pakot e trajnimit i kemi shpërndarë të gjitha materialet tjera...

Në çështjen e votimit të qytetarëve me dyshtetësi, njësoj edhe për problemet e tjera të organizimit të procesit zgjedhor, diskutuan edhe: Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Cemajl Kurtis, dhe Burim Ahmetaj.

### **3.Aktivitetet e ZRPPC-së**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve:

**Ylli Buleshkaj**: Para jush, kemi paraqitur një listë me entitetet që kanë aplikuar për akreditim të vëzhguesve. Kjo listë, i përben 34 entitete që kanë aplikuar, qoftë për vëzhgues të rinj apo disa tjera që i kanë plotësuar listat e tyre! Si total, janë: 10.308 vëzhgues të cilët i rekomandojmë për akreditim, dhe që këta i bashkohen listës së akredituar “14.385” vëzhgues. Pra, në total, nëse akreditohen edhe këta në këtë mbledhje, janë: 24.693 vëzhgues.

**Kreshnik Radoniqi** : Sa për njoftim, Ylli i lexon dhe ne i votojmë....

**Yll Buleshkaj**: Ambasada Britanike në Prishtinë ka aplikuar me 12 vëzhgues të cilët i rekomandojmë për tu aprovuar

**Me vota unanime akreditohen**

**Yll Buleshkaj** Media vendore grupi koha ka aplikuar me 59 vëzhgues të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore dhe rekomandohen për tu akredituar

**Me vota unanime akreditohen**

**Yll Buleshkaj**: Media vendore RTV puls ka aplikuar për akreditimin e 7 vëzhguesve të cilët i rekomandojmë

**Akreditohen**

**Yll Buleshkaj:** Institucioni publik Institucioni i Avokatit të Popullit ka aplikuar për akreditimin e 69 vëzhguesve të cilët do të vëzhgojnë ditën e zgjedhjeve dhe rekomandojmë aprovimin e tyre

**Akreditohe...**

**Yll Buleshkaj:** Komisioni Qendror simotër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë ka aplikuar për akreditimin e 3 vëzhguesve të vëzhgojnë në ditën e zgjedhjeve dhe rekomandojmë aprovimin e tyre

**Akreditohe ..**

**Yll Buleshkaj:** Media vendore Radio Televizioni Dukagjini ka aplikuar për akreditimin e 40 vëzhguesve të cilët do të mbulojnë ditën e zgjedhjeve dhe rekomandojmë aprovimin e tyre

**Akreditohe..**

**Yll Buleshkaj:** Media tjetër vendore ATV ka aplikuar për akreditimin e 30 vëzhguesve të cilët i kanë plotësuar kushtet ligjore dhe rekomandojmë aprovimin e tyre

**Akreditohe**

**Yll Buleshkaj:** Rrjeti i organizatave ndërkombëtare ENEMO ka aplikuar për akreditimin e 4 vëzhguesve shitesë të cilët rekomandohen për aprovim

**Akreditohe**

**Yll Buleshkaj:** Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës US embassy ka aplikuar për akreditimin e 14 vëzhguesve të cilët dëshirojnë të vëzhgojnë ditën e zgjedhjeve dhe rekomandojmë aprovimin e tyre

**Me vota unanime akreditohe**

**Yll Buleshkaj:** Media gjerman folëse Korrier Media House ka aplikuar për akreditimin e një vëzhguesi afatshkurtër që e rekomandojmë për aprovim

**Me vota unanime akreditohe**

**Yll Buleshkaj:** Media vendore apo portali Front Online ka aplikuar për akreditimin e 10 vëzhguesve të cilët rekomandohen për tu aprovuar

**Me vota unanime akreditohe**

**Yll Buleshkaj:** Media vendore lokale TV Graçanica ka aplikuar për akreditimin e 10 vëzhguesve te tyre dhe rekomandojmë aprovimin e tyre

**Me vota unanime akreditohen**

**Yll Buleshkaj:** Media tjetër lokale TV Most ka aplikuar për akreditimin e 12 vëzhguesve të cilët rekomandohen për aprovim

**Akreditohen me vota unanime**

**Yll Buleshkaj:** Partia politike e certifikuar NISMA Socialdemokrate ka aplikuar për akreditimin e 441 vëzhguesve shtesë për vëzhgimin në ditën e zgjedhjeve të cilët rekomandohen për tu aprovuar

**Akreditohen**

**Yll Buleshkaj:** Partia politike AAK ka aplikuar për akreditimin e 3952 vëzhguesve që do të vëzhgojnë ditën e zgjedhjeve

**Akreditohen**

**Yll Buleshkaj:** Partia politike e certifikuar Lëvizja Vetëvendosje ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 5049 vëzhguesve të cilët rekomandohen për tu aprovuar

**Akreditohen**

**Yll Buleshkaj:** Iniciativa qytetare Iniciativa qytetare për ndryshim ka aplikuar për akreditimin e 15 vëzhguesve të cilët rekomandohen për tu aprovuar nga KQZ

**Akreditohen**

**Yll Buleshkaj:** Media vendore Klan Kosova ka aplikuar për akreditimin e 97 vëzhguesve të cilët do të mbulojnë ditën e zgjedhjeve rekomandohen për aprovim

**Akreditohen**

**Yll Buleshkaj:** Organizata Misioni i vëzhguesve të Unionit Evropian ka aplikuar për akreditimin e 62 vëzhguesve shtesë afatshkurtër dhe 3 vëzhguesve afatgjatë të cilët rekomandohen për aprovim

**Akreditohen**

**Yll Buleshkaj:** Ambasada Norvegjeze Royal Norwegian Embassy ka aplikuar për akreditimin e 6 vëzhguesve afatshkurtër të cilët rekomandohen për aprovim



**Akreditothen**

**Yll Buleshkaj:** Media e huaj Anadollu Agency ka aplikuar për akreditimin e 3 vëzhguesve që të vëzhgojnë ditën e zgjedhjeve dhe rekomandohen për aprovim

**Akreditothen**

**Yll Buleshkaj:** Media Top channel, 2 vëzhgues.

**Akreditohet**

**Yll Buleshkaj:** Televizioni Fontana nga Istogu, ka aplikuar për akreditimin e dy vëzhgueseve afatshkurtër.

**Akreditothen.**

**Yll Buleshkaj:**

Media vendore TV Ilapi nga Podujeva ka aplikuar për akreditimin e shtate vëzhgueseve afatshkurtër.

**Akreditothen.**

**Yll Buleshkaj:** Zyra e unionit evropian në Kosove ..... , ka aplikuar për akreditimin e dy vëzhgueseve, të cilët do të vëzhgojnë në ditën e zgjedhjeve.

**Akreditothen.**

**Yll Buleshkaj:** Partia politike e certifikuar Kosova demokratik Turk partisë ka aplikuar për akreditimin e 126 vëzhguesve, të cilët rekomandohen për aprovim.

**Akreditothen.**

**Yll Buleshkaj:** Misioni diplomatik ose ambasada turke ka aplikuar për akreditimin e katër vëzhgueseve të cilët i rekomandojmë për aprovim.

**Akreditothen.**

**Yll Buleshkaj:** Media ndërkombëtarë radio free Evrope, radio ... dega në Kosove ka aplikuar për akreditimin e 10 vëzhgueseve të cilët rekomandohen për aprovim.

**Akreditothen.**

**Yll Buleshkaj:** Konsullata e përgjithshme turke në Prizren ka aplikuar për akreditimin e tre vëzhgueseve, dhe rekomandohen për aprovim.

**Akreditohen.**

**Yll Buleshkaj:** Partia politike e certifikuar LDK ka edhe 202 vëzhgues shtese të cilët kane kryer procedurën ndërkohe dhe rekomandohen për aprovim.

**Akreditohen.**

**Yll Buleshkaj:** Media publike RTK, ka kërkuar që të akreditohen 26 vëzhgues, rekomandohen për aprovim.

**Akreditohen.**

**Yll Buleshkaj:** Media vendore Index Online ka aplikuar për akreditim e 10 vëzhgueseve po ashtu për mbulim ditën e zgjedhjeve dhe rekomandohen për aprovim.

**Akreditohen.**

**Yll Buleshkaj:** Dhe e fundit, është OJQ-ë vendore më qendër ne Graçanice e cila ka aplikuar për akreditimin me 2 vëzhgues, dhe rekomandohet për aprovim.

**Akreditohen.**

**Kreshnik Radoniqi:** z. Elshani keni diçka ?

**Arianit Elshani:** Faleminderit, e pash që u akredituan edhe disa homolog tanë edhe nga Shqipëria, unë kisha rekomanduar si këshill për mardhanje më jashtë që, është organizuar në kuadër të KQZ-së të krijoj një standard, një protokoll të pritjes së tyre por, edhe të vëzhgueseve tjerë të organizatave të huaja jo qeveritare në mënyre që edhe të ju japin një pasqyre të qartë lidhur me të gjitha zonat zgjedhore. Pra, për secilën komunë dhe të ju shpjegojmë qartë se, ku ndoshta ka interes për të vëzhguar apo për të monitoruar procesin ditën e zgjedhjeve prandaj, rekomandoj që ketë ta bëjmë si KQZ-ë dhe të mos bëjmë ndonjë lëshime ne raport më mikpritjen e tyre. Mirëpo, edhe me udhëzimet apo ndihmën që mund të japim gjate ditës së zgjedhjeve dhe gjatë procesit të numërimit...

**Kreshnik Radoniqi:** Faleminderit z. Elshani, po besoj që javën tjetër mundemi më organizuar një këshill për marrëdhënie me jashtë. A ka dikush diçka tjetër...?

## **1. Raport i Këshillave të KQZ-së**

### **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPPC-së, në lidhje me pjesën e 10% të Fondit për përkrahje të subjekteve politike:

**Florian Dushi:** Atëherë, këshilli për çështje ligjore në dy takimet e fundit ka shqyrtuar rekomandimin e zyrës për regjistrim e partive politike dhe certifikime i cili ka të beje më transferimin e pjesës prej 10% të fondit për subjektet politike nga KQZ-ë organ pra i cili ka administruar më këtë pjese të fondit tek subjektet politike dhe kjo është bere duke marr për baze edhe ligjin për financimin e subjekteve politike, kërkesën e vete subjekteve politike parlamentare por gjithsesi edhe duke e par të nevojshme që komisioni qendror i zgjedhjeve të heq nga pjesa e përgjegjëses të vete administrimin e këtij fondi për të cilin nuk ka ndonjë mbështetje të qarte apo detyrime të qarte ligjore. Prandaj, në këto dy takime te këshillit për çështje ligjore ashtu siç e thash është shqyrtuar ky rekomandim në mënyre te hollësishme nga ana e këshillit për çështje ligjore dhe këshilli për çështje ligjore rekomandon KQZ-ë që të aprovoje këtë rekomandim të zyrës për regjistrimin e partive politike dhe certifikime që nga tetori d.m.th, nga ky muaj praktikisht tre mujorin e fundit të këtij viti të vitit 2021 pjesa prej 10% prej fondit të subjekteve politike i cili zakonisht është shfrytëzuar për mbështetje të punës së grupeve parlamentare përkatësisht të deputeteve të subjekteve politike të transferohet dhe të administrohet nga vete subjektet politike që kualifikohen sipas ligjit në fjale për të përfituar fonde nga buxheti i republikës së Kosovës. Ndërsa, për arsye që kjo do të behet për here të pare kësaj radhe transferim dhe kjo përgjegjësi do të bartet tek subjektet politike KQZ-ë përmes divizionit për buxhet të departamentit për administrate dhe përkrahje do të monitoroj dhe do të asistoj sipas nevojës ne këtë faze tranzitore të administrimit të fondit për një periudhe tre mujore për subjektet politike, pra rekomandimi i këshillit është që ky rekomandim për transferim të kësaj pjese të fondit tek subjektet politike nga siç ka qene më pare kur administrohej nga KQZ-ë pra të administrojnë vet subjektet politike të aprovet nga ana e KQZ-ë.

**Kreshnik Radoniqi:** Faleminderit z. Dushi. A ka dikush me diskutue ?

**Ilir Gashi:** Faleminderit, ne edhe në këshill i japim mbështetje kësaj por, kërkojmë një qartësi nga zyra, apo pjesa e financave...Kështu, pjesa e mbetur e parave të pa shpenzuara nga grupet parlamentare, a ju shkojnë subjekteve politike, apo ?

**Alim Rama:** Po ashtu, edhe unë e mbështes këtë vendim dhe mendoj që koha e administrimit të fondeve që është mbështetje e grupit parlamentar nga KQZ-ja, ka qene e stërzgjatur edhe kjo është dashur edhe më herët me u transferuar tek subjektet politike se, edhe ashtu subjektet politike janë përgjegjëse për

shpenzimin e këtyre mjeteve dhe ata auditohen nga auditorët, kështu që mendoj që është një vendim i mirë...

**Florian Dushi:** Ashtu siç e keni në draft vendim për mjetet të cilat do të transferohen në këtë tre mujorin e fundit, ne dje jemi njoftuar edhe për shumën e mjeteve të cilat gjenden aktualisht të pa shpenzuara nga subjektet politike dhe për atë që jemi njoftuar do të transferohet edhe kjo pjesë e mjeteve të pa shpenzuara të partive politike nga ana e KQZ-së dhe pjesa e parapare e mjeteve për tre mujorin e fundit të këtij vitit 2021. Pra komplet shumën do të transferohet, dhe KQZ në këtë formë do të lirohej në njëfarë mënyre nga të gjitha mjetet e subjekteve politike të cilat, i ka administruar deri në këtë fazë...

**Kreshnik Radoniqi :** Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka tjetër e hedhim në votim: kush është për...?

Më 10 vota për, miratohet rekomandimi për administrimin e plotë të fondit përkrahje e subjekteve politike nga vet subjektet politike përfituese.

### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ri shqyrtim të specifikave për format zgjedhore për zgjedhjet e lokale 2021:

**Arianit Elshani:** KOZ-ë, ka shqyrtuar kërkesën e sekretariatit për rishqyrtime të specifikave për format zgjedhore për zgjedhjet lokale të 17 tetorit. Gjate javës se kaluar kemi një vendim lidhur me procedimin e mëtutjeshëm të procedurës së prokurimit për shkak të ngecjeve që kemi pasur dhe për shkak të mos funksionalizimit të organit shqyrtues të prokurimit sido cofte gjate këtyre ditëve pas vendimit të KQZ-së sekretariati ka kontaktuar me operatorin ekonomik i cili ka dal fitues dhe i cili ju ka kthyer përgjigje që nuk mund të procedojë krahas atyre specifikave për shkak të kohës së shkurt që ka mbetur dhe mos kthimit të përgjigjeve që nuk kemi pasur nga institucioneve tjera. Sido qoftë, para vetes e keni një rekomandim lidhur me ndryshimin e specifikave në mënyre që të mundësohet mbarëvajtja e zgjedhjeve, që te kemi të gjitha format zgjedhore të shtypura për ditën e votimit. Në mënyrë që mos të pengohet ky proces, është më se e nevojshme që këto të ndryshojnë. Krahas atyre përgjigjeve që ka marr sekretariati ne si përbërje e KOZ-ë kemi shprehur kritikën tona në raport me gjithë këtë proces, pra që nga fillimi e më tani se si ka ecur kjo procedure dhe procedurat tjera mirëpo, për shkak që jemi vetëm dhjetë ditë nga dita e zgjedhjeve, e kemi të pa mundur që të procedojmë në ndonjë format tjetër. Prandaj, me katër vota për dhe një abstenim si përbërje e KOZ-it, e kemi aprovuar këtë rekomandim me kushtin që ato që janë thënë

brenda KQZ-ë gjatë mbledhjes së kaluar: që, të shkohet në auditim dhe të hetohen të gjitha këto procedura të nisura që nga korriku dhe që të merren masa edhe nga sekretariati, pra të shihet qartë se pse ka ardhur deri të kjo gjendje ku ne vetëm dhjete dite pra zgjedhjeve, na rrezikohet dita e zgjedhjeve për shkak të disa procedurave të cilat nuk kemi qene të gatshëm që të i menaxhojmë s'i duhet, dhe me kohe. Prandaj, si kryesues i KOZ-it rekomandoj që kjo të aprovohet me gjithë ato rekomandime dhe vërejtje të cilat, i kemi dhënë...

**Kreshnik Radoniqi** : Faleminderit z. Elshani...

**Florian Dushi: Po,** është e vërtetë se ajo që kryesuesi i këshillit për operacione zgjedhore e deklaroi, pra e kemi aprovuar rekomandimin e sekretariatit për të ndryshuar specifikat për materialet në fjalë. I kemi aprovuar, jo për shkak se ishim të vullnetshëm për të bere diçka të tillë, por sepse jemi gjet para një aktit të kryer do të thuaja për shkak të problemeve të cilat na kane dalë kohëve të fundit disa procedura të prokurimit dhe që nder lidhen me disa specifika të çuditshme: diku me iniciimin me vonesë të këtyre procedurave, dhe përfundimisht, me mungesën e organin shqyrtues të prokurimit publik, një organ ky i rëndësishëm i cili trajton dhe vendos lidhur me ankesat që zhvillohen në këto procedura. Duke u gjet në një situatë të tillë, por duke qene të vetëdijshëm që këto materiale janë të domosdoshme për ditën e zgjedhjeve, ne kemi vendosur që të rishikohen këto specifika të cilat, para një kohe kemi vendosur për to me qëllimin më të mire që të ruhet apo të forcohet akoma më shumë integriteti i procesit zgjedhor.

Prandaj, tha z. Dushi, unë edhe tani këtu e mbështes at rekomandim të sekretariatit por, gjithsesi kërkoj të evidentohet drejt dhe qarte edhe në procesverbal që, ne si institucione, pas zgjedhjeve duhet të shohim se çfarë ka ndodhur më këto procedura, me këto vonesa, përveç pengesave apo problemeve që na ka shkaktuar eventualisht, mungesa e organit shqyrtues të prokurimit publik. Duhet të shohim nëse, edhe vet ne si institucion apo nëse njësitë kërkuese veç e veç, departamentet apo divizionet përkatëse, thjeshte kanë bërë lëshime të tilla të cilat, kanë ndikuar në zhvillimin e shpejtë të këtyre procedurave, për çka ne jemi detyruar me u ul dhe me i rishikua procedurat të cilat, para një kohe i kemi aprovuar...

**Alim Rama: Tani,** sigurisht që ne jemi në një pozitë shumë të pa lakmueshme dhe duhet të veprojmë diçka vetëm që të sigurojmë këto formularë në ditën e zgjedhjeve dhe, sigurisht që duhet me i pas këto formularë në ditën e zgjedhjeve. Por këtu janë disa lëshime. E përkrahi çfarë thanë parafolësit, ashtu si kryesuesi i këshill për operacione zgjedhore, ashtu si kolegu Dushi por, ne në vendimin kur kemi kërkuar procedurat emergjente, kemi thënë që të shtohen ato në kushte minimale. Tash, sa i përket vendimit përsëri që ta merr KQZ-ja...! Nëse KQZ-ja s'ka marr vendim për specifikat të para atëherë, pse duhet me

marrë KQZ-ja një vendim tjetër kur ky rekomandim këtu, nuk po i referohet cilit vendim të KQZ-së...? Në qofte se mua më kujtohet, vendimi i KQZ-së ka qenë së këto procedura është dashtur me u trajtuar krejt ndryshe, është dashur me qenë procedurat për këto forma të veçanta, pra të jetë një proces i ndarë i cili, nuk u bë tani. Por, sido që të jetë, me krejt këto vrenjte, unë mendoj që duhet me shkuar një proces tjetër i brendshëm i KQZ-së, i cili i e verifikon krejt këto çka kanë ndodhë, pse nuk janë respektuar vendimet e para, pse këta - krejt formularët që janë kanë për vendvotime që kane pas për qëllime rritjen e integritetit të mëtutjeshëm të zgjedhjeve, zvogëlimin e mundësisë për rinumërime etj., nuk janë respektuar...?

Por, si do që të jetë, tani ne jemi në një situatë ku nuk kemi zgjedhje tjetër, kështu që unë mendoj se nuk ka qenë as e nevojshme që ne të marrim këtë vendim për dështimin e këtyre specifikave të veçanta, sepse ne për vendimin për “procedura ekstreme”, kemi thënë që të shtohet edhe “të rishikohet”...

**Ilir Gashi:** Edhe unë po lidhem pikërisht më këtë që tha kolegu Rama, sepse nuk e di që specifikat paraprake të mëhershme, i kemi miratuar. Ne, kemi marr një vendim për me shkuar me procedurë të përshpejtuar, faktikisht emergjente bazuar edhe në ligje dhe në nevojat e domosdoshme. Pse është e nevojshme për specifika, kur nuk është në domenin tonë, pra specifikat i ban departamenti për nevojat që ata e parashohin...

Ne, e kemi lehtësuar me e shkuar “me situata emergjente” prandaj, edhe unë e kam këtë dileme pse duhet ne më marre vendime me i trajtuar specifikat e kërkesës të cilën, e kemi para vetes! Nëse, është e nevojshme patjetër..., ama nëse s’kemi marrë për here të parë, pse për herë të dytë...? A ka mundësi me e shpjegua...?

**Florian Dushi:** Ne, disa specifika kemi aprovuar, edhe janë aprovuar se përndryshe, nëse nuk kemi aprovuar ne specifika nuk kemi nevojë as me i ndryshe...! Por, i kemi aprovuar se e kemi diskutuar edhe çështjen e specifikave që ndërlidhen më UV sprej, edhe idenë atëherë, e kemi diskutuar për ndryshimin nga UV sprej në njëfarë..., çfarë është ajo ngjyrë artikuluse, apo çfarë i thoni...! Po, më kujtohet saktë që ne i kemi diskutuar këto specifika dhe, kemi marr vendim dhe Sekretariati mundet me na ndihme në këtë drejtim....

**Arianit Elshani:** Unë e kuptoj sekretariatit tej mase në qofte se nuk janë marr ato vendime në KQZ-ë se, format zgjedhore gjithmonë kalojnë përmes KOZ-ë dhe pastaj, në KQZ-ë unë kam shpreh qëndrimin time atëherë edhe kundër trajtimit të specifikave në mbledhjet e KQZ-së, edhe në KOZ-ë. Sido qoftë, KOZ ka dhënë rekomandim për KQZ-ë që secila forme zgjedhore të jetë e personalizuar për vendvotime, pra secili vendvotim t’i ketë të gjitha materialet e saj, të gjitha format që ka duke përfshirë formularin e rezultateve,

duke përfshirë formularin e rezultateve të kandidatëve për kryetar dhe atë për kuvend komunal, pastaj zarfet dhe gjitha këto të jenë me kode të vendvotimit. Pra, deri më tani gjithë kjo praktikë të gjitha këto materiale kanë pasur të shënjuar me marker apo me kimik, kanë pasur të shënjuar apo me letra ngjitëse kanë pasur të shënjuar vendvotimin se ku kanë qëndruar ato materiale. Nga ky proces, si KOZ-ë kemi vendosur që duhet të jenë paraprakisht të shtypura në mënyrë që e para, ti lehtësohet puna gjithë atij sekretariatit, gjithë personelit që të mos ngatërrohen materialet, dhe e dyta, që ne të kemi një kontroll të qartë për secilin material se ku është dhe ku do të jetë pastaj ditës së zgjedhjeve...

Kjo, tha z. Elshani, ka qenë arsyeja pse ne kemi vendosur këtë si specifike. Realisht, ka qenë kërkesë e KOZ-ë dhe me tendencën më të mirë për ta përmirësuar edhe për ta ruajtur procesin. Sido qoftë, kjo kërkesë e jona, sot në këto afate kohore, kur jemi vetëm pak dite para zgjedhjeve është vështirë e realizueshme nga operatorët ekonomik. Është momenti kur ne po sfidohemi me vendimin që e kemi marrë paraprakisht në muajin qershor prandaj, është ky rekomandim që ajo kërkesë e jona të largohet si rekomandim dhe mos të jene të gjitha materialet...

**Kreshnik Radoniqi** : Faleminderit z. Elshani. Z. Kurteshi ?

**Sami Kurteshi**: Faleminderit. Ne, i dëgjuam këto, dhe pak a shume ne jemi të shqetësuar krejt unë nuk jam veçanërisht i shqetësuar unë jam veçanërisht i shqetësuar se këto probleme të kësaj natyre kemi par edhe përpara nuk janë të zgjedhjeve të fundit krejt zhurma që, është bërë që një vit lidhur më prokurimet me tenderët. Në të vërtetë, këtu e ka thelbin. Tash, shiko se çfarë ngjanë: kodi i vendvotimit vërtet është elementi kryesorë i sigurisë në zgjedhje, dhe këtë duhet me e majtë mend . Nëse kodi shënohet në vendvotime, i kufizon mundësitë e keqpërdorimit, në maksimum në 125 vota sa i ka një vendvotim, por me rëndësi është që s'mundet me u bart në vendvotime tjera. Ky është thelbi i krejt punës. Ne, po themi kemi marr vendime që nuk janë zbatuar, dhe unë po them krejt sinqerisht se duhet me i diskutuar ashtu siç, secili lëshim duhet me pas emër dhe përgjegjësi. Nuk është krejt sekretariati keq, edhe unë e kam ngritë dorën por, nuk kemi qare pa i mbajt zgjedhjet.

Por, tha z. Kurteshi, më vjen keq për këtë gjëra që po ndodh, dhe unë po them se kjo nuk do të duhej me na ndodh ma, dhe do të duhej një hetim i brendshëm. Edhe ajo këmbulja ime para 2 jave 3 jave a 4 jave se, a kan shkuar raportet e auditorit në prokurori, janë gjet shumë arsytetime, dhe se qel ma kush atë çështje. Dhe pikërisht këtu, janë problemet. S'kam unë asnjë çështje personale private, por ne duke bërë këto lëshime, na vijnë edhe lëshime të tjera, dhe nëse i lejojmë këto lëshime kanë me na ardhur edhe do lëshime të tjera. Dhe ne, nuk e meritojmë këtë vend këtu ku jemi ! Mua po më vjen shumë keq, dhe unë

tani e kam ngritë dorën dhe po ashtu, po më vijën keq me e ngritë dorën për arsye se nuk kam të drejtë me ja mohuar dikujt të drejtën kushtetuese për me zgjedh... A e kemi kryer punën tonë? Ne, nuk e kemi kryer punën tonë...

**Ibrahim Selmanaj:** Unë, s'dua me e përsëritë askënd por, fakti se zgjedhjet duhet me u mbajt është i vërtetë dhe kjo nuk do të thotë se duhet me e amnistuar një situatë të krijuar. Ndoshta s'po paragjykoj, ndoshta me vetëdije, edhe në koftë se kjo në vazhdimësi vjen dhe përsëritet edhe një element edhe dy elemente, edhe një element tjetër, sinqerisht edhe unë jam shumë i pakënaqur me këtë drejtim. Dhe prapë e përsërisë atë fjalën që e thash "s'ka me pasur amnisti në këtë drejtim" por, duhet të gjejmë rrugën më të mirë, edhe formën më të mirë që ne të vazhdojmë procedurën për me u mbajt zgjedhjet. Por, jam dhe insistoj që fajtori edhe me dhanë llogari, edhe përgjegjësi dhe mos me u përsërit asnjëherë më.

**Ilir Gashi:** Ne, duhet më qene të sinqerte, së pari edhe unë kërkoje që pas zgjedhjeve të bëhet një auditime dhe të dihet se ku ka pas probleme procesi. Por, nga ajo që ne po detyrohemi me marrë disa vendime dhe nga ajo që kemi diskutuar edhe në mbledhjen paraprake, e vërteta deri më sot e vetme është si pasoje e mos funksionalizimit të institucioneve të shtetit, për pasoje të mos vendimmarrjes së duhur të kuvendit të Kosovës në bashkëpunim më qeverinë e Kosovës për me krijuar institucionet përkatëse të sanksionuara më ligj që këto procese me ec më tutje! Deri sa kemi institucione jo funksionale nën përgjegjësinë e Kuvendit të Kosovës, faktikisht po paraqitet problemi edhe brenda institucionit tonë. Po shpresoj shumë që të mos jetë e gjithë kjo edhe pjesë e fajit të brendshëm, të neglizhencës apo të çështjeve të tjera...

**Kreshnik Radoniq:** Nëse nuk ka dikush diçka tjetër, e kisha hedhur në votim. Ndërsa, edhe unë po pajtohem me konstatimet që i dhatë, ndërsa është e nevojshme që pas zgjedhjeve me e marrë dhe me e rishikuar krejt çfarë kemi vepruar deri më tani, deri në përfundimin e zgjedhjeve, dhe me e pa se ku kemi qaluar. Edhe unë po mendoj që duhet një rishikim por megjithatë, unë e hedh këtë rekomandim për votim më qellim të hapjes së dyerve për t'i implementuar këto forma. Kush është për ?

Me vota unanime, aprovohet rekomandimi për rishqyrtime të specifikave për format zgjedhore.

#### **Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik**

**Fazli Stollaj:** Faleminderit, më datën 4 tetor, këshilli ka mbajtur takimin e radhës ku ka shqyrtuar tekstin i cili ka të bëjë me njoftimin lidhur me ndërrimin e qendrës së votimit "1 Tetori" në Fakultetin e Edukimit, pra këshilli e ka miratuar njoftimin i cili i informon të gjithë votuesit të cilët, në zgjedhjet e kaluara kanë



votuar në sallën e 1 tetorit: në qendrën e votimit 1912/e, dhe që në zgjedhjet e 17 tetorit do të votojnë në lokacionin e ri në fakultetin e edukimit i cili, gjendet afër bibliotekës kombëtare. Kjo ndodh për shkak se qendra e votimit që ka qenë në zgjedhjet e kaluara, tani shërben si qendër për vaksinim dhe imunizim. Ky njoftim, publikohet në ËEB faqe dhe në rrjete sociale të KQZ-së, dhe në RTK-ë, si dhe rrjete sociale te OJQ-ve. Gjithashtu, edhe njoftimi do të jete në hyrje të objektit 1 tetori në mënyre që në ditën e votimit, ata të cilët mund të shkojnë aty për të votuar dhe që s'kanë qenë deri më tani të njoftuar, ata do të njoftohen me qendrën e votimit...

**Kreshnik Radoniqi**: Në pikën “të ndryshme”, a ka dikush diçka? Nëse jo, e përfundojmë mbledhjen e 65 - të të KQZ-së.